

MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

NDËRMJET

ROMA VERSITAS ALBANIA

DHE

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

PËR

**MBËSHTJETJEN E PROJEKTIT: “Edukimi Ligjor i Studentëve Rom,
Mediatorëve Komunitar dhe të Shëndetit për të lehtësuar aksesin në
Drejtësi për Komunitet e tyre”**

Duke pasur parasysh se Organizata **Roma Versitas Albania**, e regjistruar më datë 30.05.2016, me vendim nr. 5347 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është duke realizuar disa projekte të financuara nga Roma Education Fund, Bashkimi Europian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim:

Duke pasur parasysh se qëllimi i projektit “Edukimi Ligjor i Studentëve Rom, Mediatorëve Komunitar dhe të Shëndetit për të lehtësuar aksesin në Drejtësi për Komunitet e tyre” (më tej referuar si Access to Justice for Roma) ka si qëllim të lehtësojë edukimin ligjor, dhe të përmirësojnë qasjen drejt informacionit me natyrë ligjore dhe shërbimet publike nga grupet vulnerabël si minoritetet Rome dhe Egjiptiane, duke përfshirë dhe jo vetëm, persona me aftësi të kufizuara, viktimat të dhunës në familje, dhe fëmijë në situatë rruge.

Kanë rënë dakord si në vijim:

Neni 1

Zotimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), i përfaqësuar nga Z. Robert Gajda, dhe Roma Versitas Albania, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Z. Emiliano Aliu (në tekstin e mëtejme “Palët”), konfirmojnë zotimin e tyre për të punuar së bashku drejt lehtësimit dhe realizimit të projektit: “Edukimi i Ligjor i Studentëve Rom, Mediatorëve Komunitar dhe të Shëndetit për të lehtësuar aksesin në Drejtësi për Komunitet e tyre”.

Palët pajtohen që të punojnë në mbështetje dhe në të mirë të këtij projekti.

Neni 2

Fushëveprimi

Nëpërmjet këtij memorandumi mirëkuptimi, (këteje e tutje, MoU) ndërmjet KMD-së dhe RVA-së, palët shprehin vullnetin për të bashkëpunuar dhe/ose për të mbështetur përmirësimin, dhe rritjen e qasjes së studentëve nga minoritetet rom dhe egjiptian, Mediatorëve të shëndetit, Mediatorëve komunitare, dhe grupeve të marginalizuara në aksesin në drejtësi nëpërmjet zyrës së komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Projekti: “Edukimi Ligjor i Studentëve Rom, Mediatorëve Komunitar dhe të Shëndetit për të lehtësuar aksesin në Drejtësi për Komunitet e tyre” synon që të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- 2.1. Mbështetja, edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit rreth të drejtave të njeriut tek 30 studentë Rom dhe Egjiptian nga shkollat e mesme dhe universiteti, përfutues të programeve të Roma Versitas Albania.
- 2.2. Hartimin e një moduli për studentët i cili do të përmbajë 10 leksione, ose tematika mbi të drejtat e njeriut, fuqinë kolektive, dhe mobilizimin Komunitar.
- 2.3. Rritja e ndërgjegjësimit, njohurive dhe aftësive të grupeve vulnerabël nga Romët dhe Egjiptianet për të pasur akses tek të drejtat dhe detyrimet në marrëdhënie me institucionet.
- 2.4. Forcimin e aksesit në drejtësi duke promovuar ndërgjegjësimin mbi ligjin tek grupet vulnerabël rreth të drejtave dhe lirive themelore si dhe interesat ligjore. Gjithashtu, rritjen e qasjes së grupeve vulnerabël tek institucionet e pavarura si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit, dhe Ruajtjen e të Dhënave Personale, Ndihmën Ligjore Falas, dhe ofrues të shërbimeve publike dhe sociale.

KMD do të mbështesë RVA-në duke filluar nga nënshkrimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi nga të dyja palët.

Neni 3

Kontributi i partnerëve

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Roma Versitas Albania shprehin vullnetin për të bashkëpunuar si më poshtë:

1. Shkëmbejnë informacione rreth aktiviteteve në kuadër të projektit Access to Justice for Roma;
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ofron trajnim për studentët nga minoritetet rom dhe egjiptian, mediatorët komunitare dhe të shëndetit rreth rolit, funksioneve, dhe mënyrave të qasjes ndaj zyrave të komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi;
3. Personeli i zbatimit të projektit, ofron informacione, dhe konsultohet paraprakisht me komisionerit rreth aktiviteteve të përbashkëta, duke vënë në dispozicion të dhëna të grumbulluara në terren;
4. Kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit rreth zyrës së Mbrojtjes nga Diskriminimi, dhe rolit të saj për të rritur qasjen në sistemin e drejtësisë, dhe barazisë;
5. Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ofron mundësinë e përgatitjes së video tutorialeve në kuadër të krijimit të një moduli nga RVA për edukimin e studentëve rreth aksesit në drejtësi në tërësi, dhe rolit të KMD-së në veçanti. Palët bien dakord paraprakisht për kushtet, dhe formën e realizimit të këtij aktiviteti;
6. Zyra e Mbrojtjes nga Diskriminimi ofron mbështetje dhe lehtësim për pjesëmarrësit në projektin në kuadër të aktiviteteve të llojit street law activities, për të sjellë pranë komisionerit raste të diskriminimit;
7. Roma Versitas Albania kontribuon dhe ofron mbështetje në rritjen e vizibilitetit të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi tek studentët dhe përfituesit e programeve të saj, si edhe tek rrjeti i ALUMNI;

Neni 4

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, kundërthënie apo kërkesë që paraqitet në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi zgjidhet përmes konsultimeve, pajtimit dhe/apo negociatave ndërmjet KMD dhe RVA, apo përfaqësuesve të tyre të autorizuar. Nëse Palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin kontestin në mënyrë miqësore, përmes mënyrave të përshkruara në këtë dokument brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, kontesti zgjidhet përmes arbitrazhit. Do të caktohet 1 (një) arbitruer i vetëm, i cili do të ketë kompetenca të plota për të marrë vendime të plotfuqishme dhe të detyrueshme. Autoriteti emëruer është Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit. Vendi i arbitrazhit është Tirana.

Neni 5

Njoftimi

Të gjitha njoftimet në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi konsiderohen së janë të vlefshme, nëse dorëzohen nga njëra Palë te tjetra, apo dërgohen përmes postës së regjistruar, faksit apo të skanuara dhe të dërguara te Pala tjetër në adresën e saj apo në adresën elektronike zyrtare.

Neni 6
Komunikimi

Zyrtarët përgjegjës për bashkërendimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me këtë Memorandum Mirëkuptimi janë:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Në emër të Roma Versitas Albania

Z. Robert Gajda
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Z. Emiliano ALIU
Drejtor Ekzekutiv

Neni 7
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe është në fuqi për 1 (një) vit. Cilado Palë mund ta ndërpresë Memorandumin e Mirëkuptimit pas dhënies së njoftimit me shkrim 10 ditë më herët Palës tjetër. Memorandumi i Mirëkuptimit është pa paragjykim ndaj marrëveshjeve të tjera, të nënshkuara ndërmjet palëve. Ky Memorandum Mirëkuptimi është hartuar në dy kopje identike origjinale, ku secila kopje ka vlefshmëri të barabartë për secilën Palë.

Nënshkrimet:

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

ROMA VERSITAS ALBANIA

Z. Robert Gajda

Z. Emiliano ALIU

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Drejtor Ekzekutiv



Data e nënshkrimit

Data e nënshkrimit

Prot 466
18 / 05 / 2021

18 / 05 / 2021

¹ Ky projekt zbatohet nga Roma Versitas Albania si pjesë e projektit "Për një drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri", zbatuar nga Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuar në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe financuar nga Ambasada Norvegjeze.